

**DITA NDËRKOMBËTARE E TË ZHDUKURVE ME
DHUNË**

**PËRDERISA I KUJTOJMË,
ATA JETOJNË!**

MARSH PËR DREJTËSI
Genève



30 AUGUST

**INTERNATIONAL DAY OF THE
VICTIMS OF ENFORCED DISAPPEARANCE**

Organizatori:

Shoqata kulturore Dora d'Istria
Lidhja Shqiptare në Botë



DORA D'ISTRIA
Association Culturelle



Me mbështetje të :



**DITA NDËRKOMBËTARE E TË ZHDUKURVE ME
DHUNË**

**PËRDERISA I KUJTOJMË,
ATA JETOJNË!**

MARSH PËR DREJTËSI
Genève



**NË NDERIM TË PERSONAVE TË ZHDUKUR DHE FAMILJEVE TË TYRE
MARSHI MBAHET PËR TË KËRKUAR TË VËRTETËN,
PËR TË KËRKUAR DREJTËSI PËR TË ZHDUKURIT ME FORCË DHE PËR TË MBAJTUR
GJALLË KUJTESËN E TYRE, DERISA ÇDO FAMILJE TË MARRË PËRGJIGJET QË MERITON**

Udhëzime & Orari:

13:30 – Tubimi në Parc des Crochettes

14:00 – Nisja e marshit

14:45 – Mbërritja në Place des Nations

Ekspozitë e gjallë: Foto të personave të
zhdukur

15:00 – Folës:

Alfonso Gomez -Kryetar i Qytetit të
Gjenevës

Mentor Latifi -Ambasador i Kosovës Bern

Andin Hoti -Kryetar i Komisionit Qeveritar
për Personat e Zhdukur të Kosovës

Ajla Kuduzovic -Aktiviste

Ruslan Pikhota -Ushtarak&Aktivist

Mirishahe Limani Hiler - Organizatore

Performanca artistike « Vatra » Bülach & « Ilirët » Llozanë
Homazhe

17:00 – Mbyllja e manifestimit

18:30 Homazhe në Kopshtin e të zhdukurve në Meyrin;
Familjarët e viktimave të zhdukjes me dhunë vendosin
lule tek pllaka përkujtimore të shoqëruar nga autoritetet
dhe nga shoqëria civile.

19:30 Aperitiv miqësor e solidar

Vishuni me veshje tradicionale, në nder të
origjinës suaj dhe pasurisë kulturore të qytetit
tonë.Merrni një lule me vete si simbol i kërkimit
për një vend përkujtimi.

E shtunë 30 Gusht 2025

Organizatori: Shoqata kulturore Dora d'Istria
Lidhja Shqiptare në Botë

Kontakti:

+41 79 607 46 74

info@dora-distria.ch

www.dora-distria.ch

DITA NDËRKOMBËTARE E TË ZHDUKURVE ME DHUNË

Tryeza e rrumbullakët :
E vërteta, drejtësia
dhe përkujtimi për personat
e zhdukur



Zhdukjet me dhunë janë një tragjedi universale dhe një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut. Ato shkatërrojnë jetë, fshijnë identitete dhe lënë familjet në një gjendje të pafundme pasigurie dhe dhimbjeje. Shpesh të pandëshkuara, këto krime vazhdojnë në kontekste të ndryshme – nga regjimet autoritare te konfliktet e armatosura – duke mohuar të drejtën për të vërtetën, drejtësinë dhe dëmshpërblimin.

Kjo tryezë e rrumbullakët mbledh familje të të zhdukurve, mbrojtës të të drejtave të njeriut, avokatë, studiues, gazetarë dhe përfaqësues institucionalë për të ndarë dëshmi, për të reflektuar mbi sfidat dhe për të riafirmuar angazhimin për kujtesë, të vërtetën dhe mos-përsëritjen e krimeve.

Fjalë mirëseardhjeje

•**Floreta Kabashi**, Konsulle, Konsullata e Republikës së Kosovës në Gjenevë

Moderatorë

•**Nazmi Jakurti**, President i Lidhja Shqiptare në Botë

•**Fahredin Ramiqi**

Të ftuar në diskutim

•**Andin Hoti & Kushtrim Gara**, nga Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur të Kosovës

•**Gramoz Berisha & Luljeta Sharani** (Kosovë),
•**Silvia Hodgers** (Argjentinë) Dëshmitarë –
Anëtarë të familjeve të viktimave të zhdukjeve me forcë

•**Claudio Bolzman**, Sociolog dhe profesor në Shkollën e Lartë të Punës Sociale të Gjenevës, specialist i migrameve dhe marrëdhënieve ndërkulturore

•**Butrint Ajredini**, Avokat në Dhomën e Avokatëve të Gjenevës

•**Ihsan Kurt**, Përfaqësues i shoqërisë civile, trajner, ekspert i së drejtës së azilit dhe migritimit



E diel, 31 gusht 2025 – ora 15:00

Adresse : Maison des arts du Grütli
Rue du Général-Dufour 16
1204 Genève, Suisse

Ekspozitë kolektive e arteve pamore

Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur me Dhunë, kjo ekspozitë kolektive e arteve pamore i jep zë një kujtese të plagosur, por të gjallë.

Përmes perspektivave të ndërthurura të artistëve nga Kosova, Ukraina, Franca dhe Zvicra, ajo evokon mungesën – njerëzit e dashur e të zhdukur, që arti refuzon t'i harrojë.

Çdo vepër bëhet një akt kujtese, një britmë e heshtur kundër harresës, një mënyrë për t'i sjellë në jetë ata që dhuna i zhduku.



Gani Jakupi

Është autor, skenarist, muzikant dhe gazetar, i lindur në Kosovë, në vitin 1956. Ai e filloi karrierën e tij artistike shumë herët, duke botuar mësimet grafike të tij të para si adoleshent. I vendosur në Francë dhe më pas në Spanjë, ai zhvilloi një vëllim të pasur dhe të përkushtuar pune, duke kombinuar normativën grafike, kujtesën historike dhe qëshijet politike. Autor i disa romaneve grafike të vlerësuar nga kritika, si "Mbreti i Padukshëm", "Kthimi në Kosovë" dhe "El Comandante Yankee", ai kombinon rigorozitetin dokumentar me një ndjenjë mërimi. Puna e tij eksploron figura të hamuara nga historia, luftërat për liri dhe zonat e errëta të kujtesës kolektive. Krahas romaneve grafike të tij, ai ndjek një udhëtim muzikor me projektin e tij "Gani Jakupi Connections", duke kombinuar xhazin dhe kujtesën kulturore.



Ruslan Pikhota

Artist dhe vullnetar në ushtrinë ukrainase, që nga 27 shkurti 2022, tri ditë pas fillimit të pushtimit rus. Para luftës, Ruslani punonte në një shtëpi botuese për fëmijë. Vizatimet e tij padyshim do të ilustrojnë historinë e kësaj lufte. Ai, në veprën e tij të theks të veçantë në pasqyrimin e kurajës së gruas në luftë. Pikhota ka krijuar mbi 1000 karikatura, si dëshmi e luftës. Disa janë prezantuar në ekspozita dhe janë botuar në mediat kryesore ukrainase dhe ndërkombëtare. Ai ka botuar edhe në gjuhën shqipe librin « Në llogaret e Ukrainës », i cili është pritur shumë mirë nga kritika. Këtë vit, Pijota ishte pjesëmarrës në Festivalin ndërkombëtar GranFest në Prishtinë, Kosovë, Festival ky që çdo vit sjell në Kosovë nga të gjitha shtetet evropiane.




Hazir Reka

Lindi më 11 mars 1961 në Ferizaj, Kosovë. Punën profesionale si Fotoreporter e ka filluar në vitin 1984 në gazetën studentore "Bota e Re" dhe vazhduar në "Zërin e Rinisë" ("Zëri") ku në fillim ishte Fotoreporter e pastaj edhe redaktor i Fotografisë. Fotografite e tij dokumentore dhe artistike u gjetën në Faqet e shumë revistave të ish-Jugosllavisë. Është autor i librit me Fotografji "Eja nëpër terrin Kosova 1988-1990" dhe kaotuar i disa librave. Ka hapur ekspozita personale në Zagreb, në Gjenevë, në Nevers, etj. Fotografite e tij janë prezantuar edhe në shumë ekspozita kolektive. Prej vitit 1998 është Fotograf i agjencisë "Reuters", ku mbulon Kosovën. Ka mbuluar luftën në Kosovë prej Prekazit e deri në hyrje të Forcave të KFOR-it siç i ka mbuluar të gjitha vitet e vuajtjes, dhimbjes dhe shkeljes së lirisë të shqiptarëve të Kosovës.



Ramë Dardania

Është artist që jeton dhe krijon në Gjenevë, Zvicër. Me mbi 40 ekspozita të realizuara, ai vazhdon të zhvillojë një stil unik ku karakteret dhe ngjyrat krijojnë një lojë të ndjeshme që komunikun me emocione si vuajtja, gëzimi, humbja dhe shpresa. Fytyrat dhe ndjesitë janë elemente qendrore që lidhin të kaluarën me të tashmen, duke ndërtuar një botë me të hapur përmes artit. Performancat dhe videot që ai krijon janë të ndërtuara ngushtë me pikturën, duke formuar një gjuhë të përbashkët shprehëse dhe të fuqishme. Ai vazhdon rrugëtimin e tij artistik me përkushtim të plotë, duke ndërtuar vepër që mbrojnë të mirën dhe sfidojnë të keqen. Në muajin shtator, ai prezantohet me një ekspozitë personale në muzeun Dargenba Mulhouse në Francë.




Vanesa Lika

Është një artiste shqiptare, e lindur dhe rritur në Zvicër. Aktualisht është studente në Universitetin e Gjenevës, ku ka përfunduar studimet bachelor në Shkencat e Edukimit dhe ka filluar një bachelor të dytë në Biologji. Është kryetare e Shoqatës së Studentëve Shqiptarë në këtë Universitet. Përmes artit të saj, Vanesa synon të sjellë në dritë pasurinë shpirtërore dhe estetike të kulturës shqiptare. Pjo pikturon motivet e veshjeve popullore, të punuara me finesë dhe të ngarkuara me histori por edhe fuqinë, qëndrueshmërinë dhe dinjitetin e figurave të luftëtarëve shqiptarë. Ka marrë pjesë në disa ekspozita, përfshirë një ekspozitë personale në Konsullatën e Kosovës në Gjenevë, një ekspozitë kolektive në Galerinë e Arteve në Gjiun si dhe në Panairin e Librit të Gjenevës.



Nysret Shabani

I lindur në vitin 1961 në Ferizaj, Nysret Shabani jeton dhe krijon në Francë që nga viti 1999. Ai ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë, dega Kimi dhe ka punuar për më shumë se një dekadë si profesor i kimisë në gjimnazin "Zenel Hajdini" në Ferizaj. Megjithatë, arti ka qenë gjithmonë pasioni dhe rruga e tij më e vërtetë. Që prej ardhjes në Francë, ai ka marrë pjesë në shumë ekspozita ku veprat e tij janë mirëpritur dhe vlerësuar nga publiku. Në një prej ekspozitave në Lyon, një nga pikturat e tij u shpall si më e mira nga vetë vizitorët, duke dëshmuar fuqinë dhe ndikimin emocional të krijimit të tij. Sot, qindra piktura të tij ndodhen në koleksione private dhe në shtëpitë e njerëzve, duke përcuruar mesazhin artistik dhe lidhjen personale që ai krijon me shikuesit.



Mirëseardhje : Mathias Buschbeck, kryetar i Vernier-s

Organizatori: Shoqata kulturore Dora d'Istria
Lidhja Shqiptare në Botë



E Diel, 31 Gusht 2025 – ora 14:00

Adresse : Maison des arts du Grütli
Rue du Général-DuFour 16
1204 Genève, Suisse



Në bashkëpunim me :

